

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj-Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë Xhavit Elezi dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të propozueses A.(S).S. e lindur M. nga P. Rr. “K.K.” nr. 269 , të cilin e përfaqëson me autorizim zëvendësues B.M. - avokat në Gjakovë, dhe propozuesit A.(S).S. nga Gjakova, tani me vendbanim ne boten e jashtë K. 29B.S.- Gjermani, të cilën e përfaqëson me autorizim P.P. -avokat në Gjakovë, me bazë juridike zgjidhje e martesës me marrëveshje, në seancën kryesore jo publike, të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të propozueses dhe propozuesit, më dt.13.02.2017, mori këtë;

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET martesë me marrëveshje në mes të propozuesve: A.(S).S. e lindur M. nga P. dhe propozuesit A.(S).S. nga Gjakova, e lidhur me dt..., para zyrtarit të gjendjes civile në Gjakovë, M., me nr. rendor ..., me numër të referencës: ... në kuptim të nenit 68 pika 2 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja më dt.09.11.2016 ka parashtruar kundër këtu të paditurit padi me bazë juridike zgjidhje e martesës. Mirëpo, në shqyrtimin kryesor këtu i padituri u pajtua që padia të trajtohet si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje. Ashtu që Gjykata në kuptim të nenit 68 par.4 të LFK dhe pëlqimin e palëve në procedurë, padinë e konsideroj si propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje. Në fakt nga palët në procedurë u konstatua se të njëjtit vetëm formalisht e kanë lidhur martesën në mes veti, ndërsa faktikisht martesë e këtillë nuk ka ekzistuar asnjëherë.

I autorizuari i propozueses në fjalën e tij përfundimtare deklaroj se nga provat e administruara u vërtetua se palët në procedurë faktike e kanë shkëputur bashkësinë martesore në dhjetor të vitit 2015. Nga ajo bashkësi faktike nuk ka rezultuar që të njëjtit të kenë fëmijë të përbashkët dhe pas kësaj periudhe kohore i kanë shkëputur çdo lidhje në mes tyre. Andaj, nga këto parashtrime rezulton se martesë e lidhur në mes të palëve në procedurë të zgjidhur në mes të palëve në procedurë të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët mes tyre.

Nuk kërkuan shpenzime procedurale.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave të administruara, rrethanave jo kontestuese të palëve, në kuptim të nenit 8 të LPK, e miratoj propozimin për zgjidhjen e martesës bazuar edhe në nenin 68 pika 2, të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr.2004/32 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” nr.4, të dt.01.09.2004, në tekstin e mëtejme LFK).

Nga provat e zbatuara u argumentua kjo gjendje faktike;

Në mes të palëve në procedurë nuk ishte kontestues fakti se palët në procedurë nga martesë e tyre formale juridike nuk kanë pasur fëmijë të përbashkët dhe as që presin që një të këtyllë të e kenë në mes tyre.

Nga Certifikatë Martese me nr. rendor:..., me numër të referencës...e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë, M.. me dt..., rezulton se palët në procedurë kanë lidhur martesë – më datë ... në Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë, M.

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 pika 1,2 dhe 4 të LFK, sepse martesë e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Është fakt se martesë lidhet në bazë të dashurisë, simpatisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Mirëpo, meqë në rastin konkret këto elemente qenësore mungojnë, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit të para cituar, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të përcaktuara me nenin 69 par.1 të LFK, parasheh se bashkëshortet mund të e kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioze të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë; xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme. Ndërsa shkaqet e veçanta janë të parapara në nenin 69 par.2 të LFK, ku përcaktohen si; jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike, sëmundja psikike e pa shërueshme etj. Pra, në rastin konkret kjo bashkësi martesore faktikisht nuk ka ekzistuar asnjë herë, por vetëm në mënyrë formale është lidhur.

Nga sa më sipër u vendos si në dispozitiv.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u more sipas nenit 449.1 lidhur me nenin 450 të LPK, dhe deklarimit të autorizuarit tëpropozueses dhe propozuesit.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.596/16, dt.13.02.2017

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij , Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.